



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/156  
Datë: 23.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 gusht 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkripteve nga mbledhjet: 148, 149 dhe 151 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohet ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet: 150 dhe 152 elektronike/korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/156  
Datë: 23.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 5 të Ligjit Nr. 04/L-222 për Ratifikimin e Neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Anëtarësimin e Kosovës në BZhKE, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 gusht 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim rritja e certifikatave pjesëmarrëse të Republikës së Kosovës në Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës në vlerë prej 5.089.000 € (pesë milionë e tetëdhjetenëntë mijë euro), dhe pagesa e kapitalit në shumën prej 1.437.134 € (një milion e katërqind e tridhjeteshtatë mijë e njëqind e tridhjetekatër euro), sipas Rezolutës 463 (2022) të Bordit të Qeverisë të Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës të datës 2 shkurt 2022.
2. Autorizohet Ministri i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të ndërmarrë të gjitha veprimet për zbatimin e pagesës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**A r s y e t i m**

Më datë 2 dhjetor 2023 Bordi i Qeverisë i Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës ka vendosur për rritje të kapitalit të anëtarësisë në BZhKE për shtetet anëtare përmes Rezolutës 463 (2022), sipas të cilës Republika e Kosovës duhet të paguajë kapital në shumën prej 1.437.134 € (një milion e katërqind e tridhjeteshtatë mijë e njëqind e tridhjetekatër euro) për certifikata pjesëmarrëse në vlerë prej 5.089.000€ (pesë milionë e tetëdhjetenëntë mijë euro).

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/156  
Datë: 23.08.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-213 dhe Ligjin Nr.08/L-235, Vendimit të Qeverisë Nr.13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr.12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr.01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, Vendimin Nr.04/90 të datës 26.07.2022 dhe Vendimin Nr.20/140 të datës 26.04.2023, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 gusht 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 160,000.00 € (njëqindegjashtëdhjetë mijë euro) për zbatimin e Masës 1.3 - Mbështetja e punësimit të grave dhe Masës 5 - Investimi në infrastrukturë dhe ambient të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Mjetet sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nën programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen si vijon:
  - 2.1. Për zbatimin e Masës 1.3 - Mbështetja e punësimit të grave, ndahet shuma prej 60,000.00 € (gjashtëdhjetë mijë euro) në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nën programin "Shërbimet e Punësimit" me kod 43100, kategoria e shpenzimeve "Subvencioneve dhe Transfereve"; dhe
  - 2.2. Për zbatimin e Masës 5 - Investimi në infrastrukturë dhe ambient, ndahet shuma prej 100,000.00 € (njëqind mijë euro) në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nën programin "Pensionet bazike" me kod 00100 në projektin "Renovimi i objekteve ekzistuese të DAPK-së" me kod 13484, kategoria e shpenzimeve "Shpenzime kapitale".
3. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në programin përkatës.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/156  
Datë: 23.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 14 pika 5. të Ligjit Nr.08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 gusht 2023, merr këtë:


**V E N D I M**

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej: 2,000,000.00 €, (dy milionë euro) në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me kod 205, nën programi Bashkëfinancimi me Kuvendet Komunale me kod 42000, nga kategoria e shpenzimeve kapitale, konkretisht nga projekti: kapital "Bashkëfinancimi me Kuvendet Komunale" me kod 10041 në 29 (njëzet e nëntë) projekte kapitale në përputhje me memorandumet e mirëkuptimit për projekte kapitale të nënshkruara nga Ministri i MMPHI-së dhe Kryetarët e Komunave.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi rialokohen nga projekti kapital: "Bashkëfinancimi me Kuvendet Komunale" me kod 10041 në këto projekte të reja, konform shumave të cekura si në vijim:
  - 2.1. Asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Strelc i Epërm, Strelc i Poshtëm, Dubovik, Isniq, Dubrav, Shaptej, Gramaqel, Llukë dhe Prejlep, Komuna e Deçanit, alokimi për vitin 2023 në vlerë 100,000 €;
  - 2.2. Zgjerimi i rrugës "Hamdi Kurteshi" - Komuna e Gjilanit, alokimi për vitin 2023 në vlerë 100,000 €;
  - 2.3. Asfaltimi i rrugës TINIYA YOLU (Rruga Mamushë-Nepërbishtë), Komuna e Mamushës, alokimi për vitin 2023 në vlerë 25,000 €;
  - 2.4. Asfaltimi i rrugës SKACKA YOLU (Rruga Mamushë-Medvec), Komuna e Mamushës, alokimi për vitin 2023 në vlerë 25,000 €;
  - 2.5. Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës LLUKA, Komuna e Mamushës, alokimi për vitin 2023 në vlerë 25,000 €;
  - 2.6. Asfaltimi i rrugës Mamushë-Terrnje, Komuna e Mamushës, alokimi për vitin 2023 në vlerë 25,000 €;
  - 2.7. Zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës Vërbovc, lagja Dobra-përmendorja e "Ilaz Kodrës", Komuna e Drenasit, alokimi për vitin 2023 në vlerë 57,000 €;
  - 2.8. Rregullimi i infrastrukturës në rrugën Kryesore dhe tranzitin e qytetit, Komuna e Kamenicës, alokimi për vitin 2023 në vlerë 70,000 €;
  - 2.9. Asfaltimi i rrugës "Mihajl Grameno", Komuna e Kamenicës, alokimi për vitin 2023 në vlerë 30,000 €;
  - 2.10. Asfaltimi i rrugës "Drenica", Komuna e Vushtrrisë, alokimi për vitin 2023 në vlerë 80,500 €;
  - 2.11. Ndërtimi i rrugës Kozhicë-Qyqavicë, Komuna e Skenderajt, alokimi për vitin 2023 në vlerë 50,000 €;



- 2.12. Asfaltimi i rrugës “Kulla e Lirisë”, Komuna e Shtimes, alokimi për vitin 2023 në vlerë 70,000 €;
  - 2.13. Asfaltimi i rrugës Godanc-Zborc-Carralevë, Komuna e Shtimes, alokimi për vitin 2023 në vlerë 88,000 €;
  - 2.14. Sanimi dhe rehabilitimi i rrugës së dëmtuar nga vërshimet në fshatin Pakshticë, Komuna e Podujevës, alokimi për vitin 2023 në vlerë 54,000 €;
  - 2.15. Zgjerimi, sanimi dhe riasfaltimi i rrugës kryesore në Shamalluk, L = 1787, B = 5 m, Komuna e Podujevës, alokimi për vitin 2023 në vlerë 50,000 €;
  - 2.16. Ndërtimi i rrugës Turuqicë-Herticë, Komuna e Podujevës, alokimi për vitin 2023 në vlerë 50,000 €;
  - 2.17. Ndërtimi i rrugës “Mesha Selimoviç dhe Rusolia” Kashicë-Dobrushë-Prekallë, Komuna e Istogut, alokimi për vitin 2023 në vlerë 66,000 €;
  - 2.18. Ndërtimi i rrugës “Jusuf Kovaçeviq” në Dobrushë, Komuna e Istogut, alokimi për vitin 2023 në vlerë 90,000 €;
  - 2.19. Ndërtimi i rrugës “Mehmet Ejupi” Dubravë - Kovragë, Komuna e Istogut, alokimi për vitin 202 në vlerë 100,000 €;
  - 2.20. Rekonstruimi i rrugës Reçan-Lubinje e Eperme-Lubinje e Poshtme, Komuna e Prizrenit, alokimi për vitin 2023 në vlerë 100,000 €;
  - 2.21. Projektet infrastrukturore të Zhupës dhe Podgurit, Komuna e Prizrenit, alokimi për vitin 2023 në vlerë 100,000 €;
  - 2.22. Asfaltimi i rrugës Prelez i Jerlive – Kosinë, komuna e Ferizajt, alokimi për vitin 2023 në vlerë 100,000 €;
  - 2.23. Ndertimi i Rrugës në fshatin Doblbare, Komuna e Gjakovës, alokimi për vitin 2023 në vlerë 85,381 €;
  - 2.24. Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrugës ekzistuese Bec-Sopot-Pulebardh-Liqeni i Radoniqit ne Komunën e Gjakovës, alokimi për vitin 2023 në vlerë 115,000 €;
  - 2.25. Rekonstruimi dhe zgjerimi i rrugës Junik–Rastovicë, faza 1, Komuna e Junikut, alokimi për vitin 2023 në vlerë 100,000 €;
  - 2.26. Rikonstruimim i rrugëve të asfaltuara në fshatin Llugaxhi dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Torinë, Banullë Topliqan, Kraishtë dhe Shalë, Komuna e Lipjanit, alokimi për vitin 2023 në vlerë 45,303 €;
  - 2.27. Zgjerimi i rrugës “Adem Jashari” -11 Qershori, Komuna e Hanit të Elezit, alokimi për vitin 2023 në vlerë 60,000 €;
  - 2.28. Rikonstruimi dhe asfaltimi i rrugës Lamë-Kllokoq, Komuna e Novobërdës, alokimi për vitin 2023 në vlerë 100,000 €;
  - 2.29. Ndërtimi i rrugës Drejë-Shalinovicë – Komuna e Istogut, alokimi për vitin 2023 në vlerë 38,816 €.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij Vendimi.
  4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/156  
Datë: 23.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 66 të Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës paragrafit 1. pika 1.2, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 gusht 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpalljen e zonës së mbrojtur ujore për qëllime strategjike me interes publik të ndërtimit të digës sipas projektit "Hidrosistemi Iber-Lepenc Faza I", për nevoja të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës (MMPHI), brenda zonës me koordinata prej 1 deri në 35, Komuna Shtërpcës, sipas tabelës të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Koordinatat sipas hartës janë:


NR.	X	Y
1	7506471.172	4680401.601
2	7506450.333	4680202.038
3	7505980.528	4680200.047
4	7505770.525	4680044.238
5	7505747.088	4679907.652
6	7505680.742	4679763.005
7	7505706.617	4679587.795
8	7505971.484	4679493.928
9	7506044.699	4679554.839
10	7506176.249	4679573.746
11	7506483.432	4679545.173
12	7506721.801	4679520.938
13	7506945.188	4679424.125
14	7507270.987	4679597.727
15	7507416.267	4679659.889
16	7507662.519	4679881.733
17	7507874.089	4680041.288
18	7508002.27	4680204.993
19	7508058.995	4680161.58
20	7508121.809	4680246.369
21	7508165.94	4680224.687
22	7508243.774	4680305.487
23	7508306.703	4680377.404
24	7508556.041	4680633.56
25	7508459.91	4680756.158



26	7508448.979	4680902.278
27	7508284.968	4680907.674
28	7508271.252	4680982.929
29	7507984.773	4681006.68
30	7507761.514	4680883.051
31	7507541.979	4680754.27
32	7507277.795	4680615.814
33	7507201.079	4680562.292
34	7506899.684	4680290.63
35	7506682.93	4680467.027

3. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/156  
Datë: 23.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 22, paragrafi 3. dhe nenit 23 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtën e Konkurrencës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 gusht 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për pozitat e 2 (dy) anëtarëve të Autoritetit të Komisionit të Konkurrencës i propozon Kuvendit të Republikës këta kandidatë:
  - 1.1. Florent Mehmeti;
  - 1.2. Salihe Gashi-Loku.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që emrat dhe biografitë e të propozuarve sipas këtij Vendimi t'ia procedoj për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/156  
Datë: 23.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 gusht 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Kodin e Procedurës Civile.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/156  
Datë: 23.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 gusht 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Gjykatën Administrative dhe të Punës.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/156  
Datë: 23.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 gusht 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Rregullimin e Fushës së Punësimit.
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/156  
Datë: 23.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-114 Për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 gusht 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1. e Vendimit të Qeverisë Nr. 28/99 të datës 30 shtator 2022 për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, me qëllim të shtyrjes së afatit të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave si në vijim:
  - 1.1. Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, do të mbahet nga data 1 nëntor deri me 15 dhjetor 2023.
2. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 28/99 të datës 30 shtator 2022.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/156  
Datë: 23.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 gusht 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Aderimin e Republikës së Kosovës në Konventën për Importin e Përkohshëm.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 12/156  
Datë: 23.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 24 par.6.3 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 gusht 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Mandati i Drejtorit të Agjencisë për Aviacionin Civil, z.Bujar Ejupi, ndërpritet në mënyrë të parakohshme, për shkak të shkeljeve të rënda të ligjit.
2. Shkeljet, nga pika 1 e këtij Vendimi, janë të elaboruara brenda Memorandumit Shpjegues, që bashkëngjitet si shtojcë e këtij Vendimi.
3. Obligohet Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Pala e pakënaqur ka të drejtë të ushtrojë padi për konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e publikimit të këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë
- Z. Bujar Ejupi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

---

**MEMORANDUM SHPIJEGUES**

**Baza ligjore**

Ligji nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, neni 20.1. (vi) përcakton që Drejtori i Përgjithshëm " është person me integritet të lartë moral dhe personal". Neni 20.4 pika a) i po këtij Ligji thekson që para skadimit të mandatit Qeveria mundet, "me vetë iniciativë ose pas propozimit të Ministrit, ta shikarkojë Drejtorin e Përgjithshëm vetëm nëse ai/ajo: a) ka bërë shkeljen e detyrave të tij/saj profesionale."

Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së z. Bujar Ejupi është emëruar më 22 qershor 2020 përmes Vendimit Nr.05/07 nga Qeveria e Republikës së Kosovës sipas Ligjit nr. 03/ L-051 për Aviacionin Civil, neni 20, dhe ky mandat është vazhduar pas racionalizimit të AAC-së sipas Ligjit Nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, neni 33 "Drejtori i Agjencisë i emëruar sipas nenit 20 të Ligjit bazik, vazhdon të ushtrojë detyrën deri në përfundim të mandatit".

Njëkohësisht, sipas Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, neni 24:

6: Mandati i drejtorit apo anëtarit të organit drejtues kolegjal të Agjencisë Rregullatore përfundon para afatit, vetëm për një nga këto shkaqe:

6.3. shkelje të rënda të ligjit; dhe nënpika

6.4. mungesë e rëndë e integritetit apo veprime në konflikt interesi me detyrën zyrtare;

7. Përfundimi i parakohshëm i mandatit është kompetencë e Qeverisë, në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës. [...]

**Shkeljet**

**1. Mosmiratimi i Raporteve Vjetore nga Kuvendi i Republikës së Kosovës**

Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ia ka miratuar AAC-së Raportet Vjetore të Punës për vitet 2020 dhe 2021. Përkundër këtij fakti, ankesat dhe raportet për shkelje të shumta profesionale të z. Ejupit kanë vazhduar edhe gjatë viteve 2022 e 2023.



**2. Raportimi i shkeljeve profesionale të z. Ejupi nga Bordi Mbikëqyrës i AAC-së dhe mosmiratimi i raporteve të punës nga Bordi Mbikëqyrës**  
Bordi Mbikëqyrës i AAC nuk ka miratuar Raportin Tremujor për K3 dhe K4 2021 të AAC dhe as Raportin Vjetor 2021. Më 13.05.2022 Bordi i AAC-së ka ngritur shqetësimet e veta tek institucionet mbikëqyrëse të AAC-së përmes një shkrese zyrtare drejtuar Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë. Shkresa e Bordit Mbikëqyrës është e bashkëngjitur.

**2. Raporti me shumë gjetje i Autoritetit mbikëqyrës të Islandës në emër të KFOR**  
Nga data 8 deri më 12 maj 2023, Autoriteti i Aviacionit Civil i Islandës (ISAVIA), i angazhuar nga KFOR-i, ka realizuar një vizitë vlerësuese në Autoritetin e Aviacionit Civil (AAC) të Republikës së Kosovës. Autoritetet Islandeze, me mandat nga KFOR-i, kanë raportuar gjetje në lidhje me mënyrën e menaxhimit të organizatës nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili e ka de-funksionalizuar sistemin e brendshëm të AAC-së, që ka qenë funksional ndër vite. Raporti është i bashkëngjitur.

**3. Raporti me 20 gjetje i ekspertëve austriak të kontraktuar nga EASA**  
Në dhjetor, 2022, ekspertë të Austrocontrol të kontraktuar nga EASA kanë kryer një vlerësim të situatës në AAC sa i përket menaxhimit të sigurisë në aviacion nga ky rregullator. Vizita një javore e ekspertëve ka përfunduar me një raport (bashkëngjitur), i cili identifikon 20 gjetje sa i përket mënyrës se si është menaxhuar organizata dhe sistemi i sigurisë në AAC nën udhëheqjen e Bujar Ejupit. Asnjë veprim nuk është marrë nga ky i fundit në lidhje me mbylljen e gjetjeve përkundër seriozitetit të situatës dhe ndikimit të madh që kjo e ka në siguri të aviacionit në vend. Raporti i ISAVIA i përmendur në pikën 3 poashtu konfirmon se gjetjet janë ende të hapura 6 muaj pasi që është kryer vlerësimi nga ekspertët e kontraktuar nga EASA (shih 4.1.2 c) të Raportit.

**4. Konflikti i interesit me operatorët kyç në aviacion**  
Bujar Ejupi ka konflikt interesi me dy operatorët kyç të aviacionit në Kosovë të cilat janë nën mbikëqyrjen rregullatore të AAC: Agjencia e shërbimeve të navigacionit ajror (ASHNA) dhe ANP "Adem Jashari" LKIA. Ejupi ka punuar në ANP Adem Jashari dhe nuk i është vazhduar kontrata e punës më 2014 nga LKIA, dhe si rezultat është larguar nga puna në aeroport. Gjithashtu, është larguar më 2018 nga puna edhe nga ASHNA. Përvoja e tij personale paraprake me operatorët kryesorë të aviacionit civil në Kosovë e ka afektuar tej mase mbikëqyrjen e operatorëve në mënyrë të pavarur, objektive dhe profesionale, siç kërkohet me legjislacionin në fuqi.  
Bujar Ejupi sot ka një padi aktive ndaj operatorit LKIA të ANP "Adem Jashari" me kërkesë për kompensim për shkeljet të marrëdhënies së punës. Padia ka numrin C.nr. 683/20 në degën në Lipjan të Gjykatës themelore. E rëndësishme që të theksohet është se pas shkeljes së kontratës nga LIMAK ndaj Bujar Ejupit, ky i fundit ka bërë padi ndaj LIMAK dhe padia është ende aktive, ndërsa Ejupi është emëruar Drejtor i Përgjithshëm në AAC nga Qeveria e Kosovës me vendim nr.05/07 të datës 22.06.2020. Ejupi ka dështuar t'i shmanget këtij konflikti të interesit duke pasur parasysh se si Drejtor i Përgjithshëm i AAC-së është rregullator i LIMAK-ut, operatorit i cili e largoi nga puna dhe prej të cilit kërkon kompensim.

**5. Shkelja e Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Ajrore Evropiane - HPEA**  
Ligji për Aviacionin Civil është plotësuar më 05.09.2022 në bazë të Ligjit Nr. 08/L-063 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, AAC-së i janë dhënë përgjegjësinë për rregullimin e transportuesve ajror, që deri atëherë ishte përgjegjësi e Ministrisë së MMPHI, dhe Z. Bujar Ejupi në kundërshtim me Protokollin IX të Marrëveshjes HPEA ka lëshuar leje sezonale për operatorët ajror të BE-së si dhe ka dështuar të nxjerrë rregulloret përkatëse si AAC në zbatim të këtij Ligji. Do të ju dërgojmë si dëshmi vetëm dy vendime që i ka lëshuar leje sezonale për avio kompanitë e BE-se, sepse ka edhe shume te tjera.



#### **6. Dështimi që të marrë masa për zbatim të Vendimit nr. 01/2021 të AAC**

Më 19 janar 2021 Bujar Ejupi ka nxjerr Vendimin nr. 01/2021 të AAC-së për hapjen e tregut dhe tarifave të shërbimeve në tokë, kurse të njëjtin nuk e ka zbatuar, duke amnistuar operatorin LKIA. Njëkohësisht, Ejupi ka akuzuar publikisht dhe para Komisioneve Parlamentare operatorin dhe stafin e AAC-së (tij) deri në shkarkim për mos hapjen e tregut. Për moszbatimin e Vendimit, Ejupi nuk ka marrë asnjë masë që të detyrohet operatori për zbatim. Moszbatimi i vetëdijshtëm i vendimit është shkelje e rëndë.

#### **7. Mos vjelja e tarifave për shfrytëzimin e hapësirës ajrore**

Gjatë takimit me Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Kosovës në vitin 2023, Ejupi vet ka pranuar se nuk ka ndërmarrë asgjë si autoritet përgjegjës për të kërkuar nga ASHNA që të faturojë shërbimin të cilin e jep për kompanitë ajrore që aterrojnë në Kukës, duke dëmtuar kështu buxhetin e shtetit që dy vite.

#### **8. Abuzimi me masa disiplinore ndaj stafit**

Bujar Ejupi ka keqpërdorur autoritetin publik duke abuzuar me masa disiplinore kundër stafit në AAC. Për shkak të përndjekjes së vazhdueshme stafi i diskriminuar janë bashkuar në një shoqatë sindikale. Diskriminimi është vërtetuar në Raportin e Avokatit të Popullit A. nr. 474/2021 të datës 09 qershor 2022. Megjithatë, nuk ka pasur kurrfarë reflektimi nga Ejupi pas këtij raporti, përkundrazi intensifikim të përndjekjes së stafit që është ankuar.

Tabela-dëshmi e bashkëngjitur evidenton masat disiplinore që i ka iniciuar dhe shqiptuar Bujar Ejupi. Shumica e këtyre masave disiplinore, pas procedurës së ankesës në KPMSHCK janë anuluar nga ky i fundit si të pabaza dhe të paligjshme. Kjo mënyrë e menaxhimit përmes ndëshkimit vetëm se ka përkeqësuar atmosferën e punës në organizatë dhe ka ulur ndjeshëm efikasitetin e punës duke shpërqendruar stafin nga detyrat e rëndësishme të mbikëqyrjes së sigurisë.

#### **9. Diskriminimi gjinor i ushtruar ndaj grave profesioniste të AAC-së**

Bujar Ejupi ka ushtruar dhunë psikologjike ndaj 5 grave profesioniste në AAC duke i diskriminuar dhe përndjekur në vazhdimësi, peticionin e të cilave e ka shqyrtuar Komisioni parlamentar për të drejtat e njeriut. Lidhur me këtë, Kryesuesja e Agjencisë për barazi gjinore ka përcjellë shqetësimet me shkresën e grave për ZKM-në më 8 korrik 2022 (bashkëngjitur). Për shqetësimin e njëjtë, Kryesuesja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione ka ftuar Drejtorin e AAC Bujar Ejupi para Komisionit. Bujar Ejupi ka përndjekë këto gra duke iu shqiptuar sistematikisht vërejtje, duke i vlerësuar me nota të dobëta, duke iu tërhequr kredencialet e inspektorëve deri në përjashtim nga puna të Drejtoreshës për bashkëpunim ndërkombëtar dhe rregullim ekonomik të aviacionit pas 15 vite pune në këtë institucion.

#### **10. Degradimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të sigurisë së aviacionit**

Siguria e aviacionit civil mbështetet në kapacitetet e mbikëqyrjes-inspektorët, ndërsa Ejupi ka dëmtuar kapacitetet mbikëqyrëse të sigurisë dhe rregullimit ekonomik të aviacionit duke larguar kredencialet nga inspektorë të profileve specifike dhe me numër deficitar, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Kapacitetet mbikëqyrëse të aviacionit janë obligim i shtetit dhe Kosova ka investuar shumë në këtë profil të kuadrove.

#### **11. Dëmtimi i reputacionit të AAC-së dhe Republikës së Kosovës**

Ka dëmtuar rëndë imazhin dhe reputacionin e AAC-së si rregullator i besueshëm i sigurisë së aviacionit karshi publikut, institucioneve ndërkombëtare me të cilat punon AAC dhe operatorëve që i rregullon AAC.

#### **12. Dështimi për zbatim të Ligjit Nr. 08/L-063 lidhur me Rregullimin e brendshëm të AAC-së**

Ka dështuar të zbatojë Nenin 41 të Ligjit Nr. 08/L-063 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhëse të Agjencive të Pavarura, i cili kërkon që Autoriteti i Aviacionit Civil brenda gjashtë (6) muajve, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të hartoj dhe miratoj Rregulloren për organizimin e brendshëm në pajtim me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.

#### **14. Hartimi i jashtëligjshëm i projekt-rregullores së brendshme**

Në kundërshtim me Nenin 11 paragrafi 13.4 dhe nenin 14 të Rregullores (QRK) nr. 1/2020 për standardet e organizimit të brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës etj. Bujar Ejupi ka hartuar vet projekt rregulloren e brendshme të AAC të cilën e ka dërguar për miratim në MPB më 2 qershor 2023. Sipas neneve të cekura më lart, hartimi i projekt rregullores është kompetencë e Grupit Punues dhe jo e Drejtorit të Përgjithshëm. Bujar Ejupi nuk e ka përfillur punën e Grupit Punues për hartimin e projekt-rregullores duke dërguar një version të vetin në MPB. Në letrën përcjellëse të draft-rregullores dërguar në MPB më 2 qershor 2023, Bujar Ejupi konfirmon se ai vet e ka konsoliduar draft rregulloren e brendshme të AAC të cilën e ka dërguar për miratim.

#### **15. Lëshimi i aprovimeve afatshkurtra të ofruesve të shërbimeve në tokë pa bazë ligjore**

Edhe pse Rregullorja (AAC) Nr. 04/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (AAC) 05/2019, parasheh Aprovime afatgjata, Ejupi ka vazhduar të lëshoj miratime afatshkurtra për ofruesit e shërbimeve në tokë "ExFis" dhe "LKIA" edhe pse i kanë përmbushur të gjitha kushtet e kërkuara, duke cenuar integritetin dhe autoritetin e AAC, meqenëse këto miratime afatshkurtra i vazhdon pa asnjë kërkesë shtesë dhe duke mos aplikuar dhe kërkuar pagesën e tarifës përkatëse.

Duke i pasur parasysh atë që e thamë si më sipër konstatojmë se Drejtori aktual i AAC Bujar Ejupi ka bërë shkelje të rënda ligjore, ka demonstruar në vazhdimësi mungesë të rënde të integritetit dhe konflikte të interesit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare.